

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Analiza - Kush fitoi në Londër? Ja e vërteta e arbitrazhit për Aeroportin e Vlorës
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917533/kush-fitoi-ne-londer-ja-e-verteta-e-arbitrazhit-per-aeroportin-e-vlores/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:10:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:33:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ca8175c0694a1f9494a1db0eece09c66a07bd402d5340ce99abba62e1fe9d44
TEKSTI	2131147ea026bb5572df926390974da49f5d9102abf80cf90a333fb2556625c4
PAMJA	7856e82c222504f70242579b27ab7a7e539835e604134b62c275399f660e95e4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6ffaaff1e620102ca58bd73e82482c9fcb114fceb92d3688eee5b86c0bc7bdee
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4f41e4bbd5d1a7a4ac13493ee37230fd53ce6e6428b4fbf05933a9d422fc171d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6ffaaff1e620102ca58bd73e82482c9fcb114fceb92d3688eee5b86c0bc7bdee>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyc

Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

By Pass i Elbasanit/ 'Karakçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen

Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Kush fitoi në Londër? Ja e vërteta e arbitrazhit për Aeroportin e Vlorës

11:33, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN**Nga Klodian Tomorri**

Dy ditë më parë 'Kapitali' publikoi lajmin se Gjykata e Arbitrazhit në Londër bllokoi qeverinë shqiptare për shtetëzimin e Aeroportit të Vlorës. Një ditë më parë, qeveria reagoi përmes një deklaratë zyrtare të ministrisë së Infrastrukturës ku pretendonte se fituesja e arbitrazhit paraprak ishte ajo dhe jo koncesionari. Por si qëndron e vërteta?

Në 5 gusht, Ministria e Infrastrukturës njoftoi zgjidhjen e kontratës së koncesionit për Aeroportin e Vlorës. Sipas klauzolave të parashikuara në kontratë, 30 ditë pune pas njoftimit të zgjidhjes, hynte në fuqi ndërprerja e kontratës. Në rastin konkret, kjo i takonte datës 17 shtator.

Por çfarë do të ndodhte në këtë datë? Hynte në fuqi automatikisht neni 15.8 i kontratës së koncesionit. Ky nen sanksion sa më poshtë:

1-Kontrata e koncesionit pushon së qënuri

2-Koncesionari i dorëzon qeverisë pa asnjë kosto ose shpenzim posedimin e VIA-s, të gjitha pronat dhe asetet e saj përfshirë aeroportin si dhe të gjitha skicat apo dokumentet e projektit.

Nga ana tjetër qeverisë i linden të drejtat e mëposhtme:

1-të hyjë dhe marrë kontrollin e menjëhershëm operacional të VIA-s, Aeroportit dhe çdo prone të luajtshme

2-të kërkojë që e gjitha vendndodhja dhe prona e paluajtshme, asetet t'i dorëzohen menjëherë asaj

3-të zgjedhë dhe zëvendësojë koncesionarin me një operator pasardhës

4-të marrë posedimin e të gjithë pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi ose dhënë me qira nga koncesionari

5-të transferojë pronësinë e Aeroportit dhe gjithë pasurive të paluajtshme nga koncesionari tek autoriteti kontraktues.

Meqë Enea Karakaçi pretendoi një ditë më parë se e ka fituar arbitrazhin, pse nuk shkon të marrë aeroportin, pronat e tij dhe shoqërinë koncesionare siç thotë kontrata koncesionare?

Arsyeja është e thjeshtë. Arbitrazhi e bllokoj qeverinë të aplikojë nenin 15.8 të kontratës duke i hequr praktikisht mundësinë për ta shtetëzuar aeroportin deri sa të konstituohet gjykata e arbitrazhit dhe ta shqyrtojë çështjen në themel. Pra mbi kontratën, arbitrazhi ka vënë masë sigurie duke e ndaluar qeverinë që ta shpronësojë aeroportin.

Por pse qeveria bërtet për fitore duke theksuar se gjykata rrëzoi dy nga tre kërkesat e VIA-s dhe la në fuqi vetëm një masë lehtësimi të përkohshme? Këtu qeveria luan me fjalët dhe gjysmë të vërteta.

Kërkesa e parë e VIA-s ishte që arbitrazhi të detyronte qeverinë të ulëj për ndërmjetësim me VIA-n. Kjo kërkesë u rrëzua nga arbitrazhi për një motiv shumë të thjeshtë. Arbitri paraparak tha se ai nuk mund ta detyronte dot qeverinë që të ulëj në ndërmjetësim, nëse ajo nuk dëshiron. Sipas vendimit, qeveria kishte 30 ditë kohë për t'u ulur në ndërmjetësim dhe ajo nuk e bëri këtë.

"Unë konstatoj se qeveria ka shprehur në mënyrë të prerë pozicionin e saj se nuk synon të angazhohet më tej në ndërmjetësim, dhe nuk është në kompetencat e mia që ta detyroj MIE-n ta bëjë këtë," arsyeton arbitri.

Pra, rrëzimi i kësaj kërkesë të koncesionarit, të cilën qeveria e quan fitore për të, është në fakt një koburë në kokën e shtetit. Nesër kur çështja të gjykohe në themel, gjyqtarët do të kenë mes të tjerave edhe argumentin që qeveria refuzoi ndërmjetësimin.

Kërkesa e tretë e koncesionarit u rrëzua për të njëjtën arsye. Kjo kërkesë synonte të zgjaste me 60 ditë afatin, që VIA të dorëzonte padinë e themelit të arbitrazhit për t'i lënë kohë ndërmjetësimit për gjetjen e një zgjidhje.

Arbitrija e urgjencës, Cecilia Carrara, e rrëzoi shtyrjen prej 60 ditësh që kërkonte VIA sepse konstatoi se afati i fundit për të dorëzuar padinë kishte mbërritur tashmë më 16 Shtator 2026 dhe VIA ishte e lirë të niste menjëherë arbitrazhin kryesor pa pasur nevojë për urdhra të tjerë ndërmjetësues.

Tani të kthehemi tek ajo që ministria një ditë më parë e quajti si fitoren më të madhe të shtetit. Atë se gjykatësja nuk pranoi kërkesën kryesore të VIA-s, përkatësisht pezullimin e zgjidhjes së kontratës së koncesionit.

Por çfarë do të thotë kjo?

Përgjigja është shumë e thjeshtë. Gjykata nuk mund ta ndalojë dot qeverinë që ta marrë aeroportin me mjete të tjera përtej nenit 15.8.

Pra, gjykata nuk mund ta ndalojë dot qeverinë që nesër të bëjë pazar me koncesionarin dhe ta marrë aeroportin kundrejt një shpërblimi. Ose të çojë ushtrinë dhe ta marrë atë me dhunë, pavarësisht se kjo do të kishte reperkursione të rënda për interesin e shtetit në gjykimin e themelit.

Arbitri arsyetoi se nuk mund të pezullonte zgjidhjen e kontratës për arsye sepse së pari, kjo nuk ishte e parashikuar në kontratë dhe së dyti ku urdhër do të kishte pasoja, të cilat nuk ishin të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

Pra, qeveria mund ta marrë aeroportin ose me pazar ose me dhunë. Por arbitri e ka ndaluar qeverinë ta marrë aeroportin sipas parashikimeve në kontratën koncesionare, të cilat janë në nenin 15.8, sepse ky nen është në masë të plotë sigurie. Me pak fjalë, arbitri e ka ndaluar qeverinë ta marrë aeroportin në mënyrë të ligjshme.

Pra, e thënë shkurt, qeveria mund të vazhdojë me zgjidhjen e kontratës. Mund të vazhdojë të hapë edhe një tender për të gjetur një koncesionar të ri. Por çdo marrje e aeroportit do të hidhte në erë interesat e shtetit në gjykimin e themelit. Kjo është arsyeja se pse qeveria nuk e merr dot aeroportin sot.

Madje, aq i rreptë është ndalimi që i ka bërë arbitri qeverisë, saqë edhe deklaratën që ministria publikoi një ditë më parë e ka cilësuar si frustrim dhe pengim të vendimit paraparak.

Kapitali ka mësuar se menjëherë pasi ministria nxori deklaratën ku bërtiste për fitore, MABCO e Pacollit iu drejtua zyrtarisht arbitrit duke e vënë në dijeni. Pas kësaj kërkesë, gjyqtarja ka reaguar menjëherë duke i tërhequr vëmendjen qeverisë që të mos dëmtojë masën e sigurisë duke e njoftuar zyrtarisht me email.

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

Pra, ne situaten e sime qe ka vendosur Arbitrazhi, kontrata nuk ka pushtuar se qeni dhe qeveria nuk ka te drejte ta marrë aeroportin në mënyrë të ligjshme. Kjo situatë do të jetë në fuqi, derisa të konstituohet trupi gjyqes i arbitrazhit dhe të rishqyrtojë masën./KAPITALI

© SYRI.net

Lexo edhe:



Këshilli i Europës ngre alarmin: Në spitalin e burgut dhe të Shënkollit trajtim çnjerëzor dhe poshtërues! Zhgënjyese nga qeveria



KIE ngre alarmin: Burgu i Shënkollit me 200 shtretër, ka 469 të burgosur! Me të sëmurët edhe vrasës me pagesë



FOTO/ Mijëra njerëz protestojnë në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së për krime lufte

TË NGJASHME



Firmosi me urgjencë ligjin e Ramës për pagat e magjistratëve/ Bardhi: Asnjë surprizë nga roja e godinës së Parlamentit



Situata alarmante me kontratat publike dhe koncesionet, Grupi PD propozon paketë ligjore: Gjurmim e kontroll çdo pasurie publike



E urdhëroi Taulant Balla/ Bajram Begaj firmos me urgjencë ligjin e Ramës për pagat e magjistratëve



Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur



By Pass i Elbasanit/ 'Karakaçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen



Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës



'Rama si monark, baronët mbledhin taksat', Hasimja: 'Kayo' në Shëndetësi, monopolizim e feudalizëm

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.